



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## Njoftim publik

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër 05-015/02-16391/25 dt. 31.01.2025, në emër të aplikuesit “Delta Invest” shpk, përmes së cilës kërkohet të emërtohen rrugët dhe të caktohet adresa për ndërtimin e kompleksit afarist – banesorë “Delta”. Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., Neni 7, pika 1, pika 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (10586) si dhe ka bërë propozimin për emërtimin e kësaj rruge.

Emri i propozuar: **ÇATIN SARAÇI**– (1902–1974) Piktur Artist i Merituar,  
**GJON SIMONI** (1936 – 1999) – Kompozitor,  
**GANI XHAFOLLI** (1945 – 2015) – Shkrimtar.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 17.03.2025 deri më 24.03.2025, në E-mail adresën: [urbanizmi@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@rks-gov.net)

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: \_\_\_\_\_

